

LOGO

Mësimi më i madh në botë

*“Unë besoj se të gjithë fëmijët kudo që jetojnë, meritojnë një mundësi për sukses në jetë. Unë jam krenare që e përkrah këtë mësim të rëndësishëm dhe ndihmoj në përhapjen e mesazhit se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të jetojnë të çliruar nga frika e dhunës dhe të jenë në gjendje ta ndjekin ëndrrën e tyre”*

Serena Uiliams  
Teniste profesioniste,  
Ambasadore e UNICEF-it

## **Njohja e Dhunës në Bashkësi**

### **Lënda**

Edukimi qytetar

### **Rezultati i mësimit**

- Të kuptohet se çka është dhuna dhe si mund të ekzistojë ajo në forma të ndryshme
- Të hulumtohen arsyet e ndryshme të dhunës anekënd botës
- Të krijohen lidhje ndërmjet përvojave lokale dhe përvojave globale të dhunës
- Të zhvillohen solucione për parandalim të dhunës

### **Përgatitja**

- Lexojuani arsimtarëve shënimet për dhunën kundër fëmijëve - shih Shtojca 1
- Rregullojeni lidhjen e internetit, që të shikoni një video pesë minutash në Youtube
- Përgatitni një tabelë në të cilën do t'i shënoni sugjerimet e nxënësve
- Shtypni ose mbani në dispozicion tregimet e fëmijëve të përfshira në Shtojcën 2

Shënim: Ky mësim mund të realizohet edhe pa qasje në internet

### **Koha e përgjithshme**

60 minuta

### **Mosha**

11-14 vjeçare

16 Paqe dhe drejtësi

## Hyrje

15 min

Filloni diskutim rreth dhunës – cilat fjalë i asocion grupi me dhunën? Mendoni më gjerë rreth formave të ndryshme të dhunës, përfshirë edhe ato që mund të ndodhin në bashkësitë e tyre dhe ato të cilat i njohin nga lajmet vendore dhe ndërkombëtare (keni ndjeshmëri për nevojat e nxënësve tuaj dhe familjeve të tyre, të cilët ndoshta kanë përjetuar dhunë).

Shënoni këta fjalë në një copë letre. Lëvizni brenda grupit dhe kërkoni nga secili t'i ndajë me të tjerët fjalët, që ua asocojnë dhunën.

A ka ndonjë lloj të dhunës, që shfaqet më shumë se njëherë? (p.sh. dhuna fizike dhe emocionale, konflikti ose dhuna e bandave?)

## Hulumtimi i dhunës anekënd botës

Mblidhni ta shikojnë së bashku tregimin e Brajanit në [www.youtube.com/watch?v=2JEy2hvjJ0g](http://www.youtube.com/watch?v=2JEy2hvjJ0g)

Shënim: Po ashtu mund ta lexoni tregimin e Brajanit nga Shtojca 2.

Pyetni nxënësit në çifte të diskutojnë filmin dhe të shënojnë gjithçka që i ka befasuar.

Kërkoni nga nxënësit t'i lexojnë tregimet e fëmijëve. Pastaj nxënësit duhet të diskutojnë ose t'i shënojnë përgjigjet e pyetjeve në vijim, të cilat kanë të bëjnë me tregimet:

- Cilët ishin viktimat e dhunës dhe cilët ishin autorët e dhunës në film dhe në tregimet?
- Për cilat lloje të dhunës keni mësuar? A dallojnë këta nga llojet e dhunës të shënuara në fillim të mësimi?
- Cilët ishin faktorët, të cilët shpinë në ndodhjen e dhunës? Inkurajoni nxënësit të mendojnë në lidhje me çështjet nga më të gjera siç është varfëria dhe papunësia e deri të faktorët lokalë siç janë sjelljet e njerëzve ndaj dhunës dhe streset e të qenit persona të rinj.

Kërkoni nga klasa që bashkërisht të japin informacion kthyes/të diskutojnë në lidhje me pyetjen e fundit. Theksoni ngjashmëritë ndërmjet secilit tregim dhe përvojave personale të fëmijëve ose njohurive paraprake të tyre.

## Çka mund të bëhet?

Kërkoni nga nxënësit të diskutojnë në çifte dhe të merren vesh për tre veprime, të cilat mund ta parandalojnë çfarëdo forme të dhunës, të cilën ata e kanë parë, ose dëgjuar në bashkësitë/shkollat e tyre. Përkujtojani nxënësve llojet e dhunës, për të cilat keni diskutuar paraprakisht dhe faktin se sjellja e dhunshme mund të merr forma të ndryshme. Diskutoni këta veprime me gjithë klasën dhe shënoni ato në dërrasë (tabelë). Nxënësit mund të votojnë për t'i përcaktuar pesë veprimet kryesore dhe për të prodhuar një manifest për të bërë ndryshim në bashkësinë e tyre.

### **Ndërmerrni veprime kundër dhunës në bashkësi**

Këtë listë të shkurtër shndërrojeni në plan aksionar ose ekspozitë klase. Diskutoni sesi nxënësit do të mund ta shtrijnë mesazhin e tyre më gjerë në shkollën ose bashkësinë e tyre.

#### **Ndërmerrni masa për Qëllimet globale**

Si edukator keni fuqinë t'i kanalizoni energjitë pozitive të nxënësve dhe t'iu ndihmoni atyre të besojnë se nuk janë të pafuqishëm, se ndryshimi është i mundshëm dhe se ata vetë mund ta drejtojnë atë.

Projekti për ndryshim "Unë mund t'iu dal ballë sfidave" i fton fëmijët të ndërmarrin veprime, të bëjnë ndryshime për moshatarët e tyre dhe t'i ndajnë ato me fëmijët anekënd botës.

Vizitoni [www.dfcworld.com](http://www.dfcworld.com) që të filloni

Për të zbritur një pako mësimesh të *projektit për ndryshim*, gjegjësisht një pako të thjeshtë këshillëdhënëse me të cilën të rinjtë do të mund të marrin ndonjë veprim vizitoni

[www.globalgoals.org/worldslargestlesson](http://www.globalgoals.org/worldslargestlesson)

### **Dhuna kundër fëmijëve**

## **INFORMACIONE PARAPRAKE PËR ARSIMTARËT NË LIDHJE ME DHUNËN KUNDËR FËMIJËVE**

Dhuna, eksploatimi dhe abuzimi i fëmijëve është problem global. “Ne po e zbulojmë faktin se fëmijët gjithandej përjetojnë dhunë ekstreme në jetën e përditshme,” ka thënë Suzan Bizel, kryesuese globale e UNICEF-it për mbrojtje të fëmijëve.

Dhuna kundër fëmijëve është e definuar në nenin 19 të Konventës së OKB-së mbi të drejtat e fëmijëve si “të gjitha format e dhunës fizike ose mendore, padrejtësia dhe abuzimi, braktisja ose trajtimi me neglizhencë, keqtrajtimi ose eksploatimi, përfshirë këtu edhe abuzimin seksual”.

Ekzistojnë lloje të ndryshme të dhunës, përfshirë edhe dhunën fizike, psikologjike dhe seksuale. Ajo mund të jetë e drejtpërdrejtë ose indirekte. Për shembull, dhuna drejtpërsëdrejti mund ta ndryshojë jetën ose të jetë shkas për mbarim të jetës përmes dhunës fizike. Po ashtu ajo mund të jetë indirekte, si për shembull të qenit dëshmitar i dhunës në shtëpi ose të qenit dëshmitar i efekteve të dhunës në shtet ose bashkësi.

Dhuna mund të ndodhë prapa dyerve të mbyllura; UNICEF-i beson se një përmasë e madhe e dhunës ndaj fëmijëve ngel pa u raportuar.

Ne po ashtu e dimë se dhuna mund t'i përkeqësojë problemet ekzistuese të zhvillimit. Për shembull, ajo mund ta pengojë fëmijën nga mësimi, nëse shkolla shfrytëzohet si bazë ushtarake. Po ashtu dhuna mund të ketë ndikim afatgjatë për zhvillimin e trurit të fëmijës, që do të thotë se ata fëmijë nuk janë në gjendje ta arrijnë potencialin e plotë.

**Nëse dëshirojmë të arrijmë progres në krijimin e botës më të mirë për fëmijët, atëherë prioritet duhet të kemi parandalimin e dhunës.**

## **Ku kemi parë sukses**

Ne e dimë se dhuna mund të parandalohet dhe se ekzistojnë mënyra për parandalim të dhunës dhe mbështetjes së fëmijëve, të cilët e kanë përjetuar atë. Ja disa shembuj:

### **Strategjia: Mbështetja e prindërve, kujdestarëve dhe familjeve**

Një studim trevjeçar në Turqi ka treguar se krijimi i ambientit pozitive familjar për nënat e privuara nga të drejtat dhe fëmijët e tyre ka rezultuar në 79 për qind rënie të disiplinimit fizik. Nënmat kanë marrë pjesë në sesionet e rregullta për diskutim në lidhje me kujdesin prindëror, të drejtuar nga koordinatorët lokalë dhe janë mbështetur nga nënat e bashkësisë së njëjtë, të cilat i kanë vizituar ato në shtëpi për t'i trajnuar në lidhje me teknikat prindërore.

### **Strategjia: Ndhimja e fëmijët në menaxhimin e rrezikut me të cilin përballen**

Një program i realizuar në 150 shkolla në Brazil iu ndihmon fëmijëve, të cilët jetojnë në lagje të varfra, t'i tejkalojnë lëndimet emocionale, të cilat i kanë pësuar si rezultat i dhunës. Programi punon në drejtim të riintegrit të fëmijëve në shoqëri dhe ndihmon në mbrojtjen e tyre nga dhuna potenciale e mëtejme.

### **Strategjia: Promovimi dhe ofrimi i shërbimeve mbështetëse për fëmijët**

Stacionet policore në Sudan kanë themeluar njësi për mbrojtje të familjeve dhe fëmijëve, të cilat në masë të konsiderueshme e kanë rritur qasjen në shërbime policore të viktimave të dhunës dhe të fëmijëve, të cilët kanë problem me shkeljen e ligjit. Para se të krijohen këto njësi, policia nuk kishte gjithnjë kohë t'i investigojë rastet e abuzimit seksual dhe fizik të fëmijëve, me çka shumë krime ngelnin të paraportuara. Një pilot projekt tjetër me 18 njësi është themeluar anekënd Sudanit.

### **Strategjia: Implementimi i ligjeve dhe politikave për mbrojtje të fëmijëve**

Në vitin 1979 Suedia është bërë shteti i parë, i cili e ka ndaluar me ligj çfarëdo forme të dhunës trupore (formë e ndëshkimit fizik, e cila përfshin shkaktim të qëllimshëm të dhimbjes me qëllim që të dënohet ndonjë person ose fëmijë). Kjo ka rezultuar në 80 për qind të rënies së ndëshkimit trupor gjatë periudhës 35 vjeçare.

## Shtojca 2: Tregime të fëmijëve të cilët kanë përjetuar situata të dhunës

### Tregimi i Brajanit El Salvador

Brajani është 11 vjeçar gati të kalojë në klasë të pestë. Ai e ka ëndje ta vozisë biçikletën dhe të luajë futboll me gjyshin e tij. Ai jeton me nënën e tij në një bashkësi në brendi të Santa Tecia në El Salvador.

Para disa viteve, vëllai i tij më i madh filloi të sillet disi më ndryshe. Ai filloi të shoqërohet me një grup shokësh, të cilët i njihje Brajani si anëtarë bandash. Ai filloi të pijë cigare dhe të konsumojë drogë, madje pas një kohe u bë i dhunshëm. Një ditë vëllai e sulmoi Brajanin në gjumë dhe pa ndërpre e godiste me shqelma pa ndonjë arsye.

Për fat të keq para një viti vëllai i Brajanit vdiq për shkak të mbidozimit me drogë. Shokët e tij ikën dhe e braktisën ashtë të shtrirë në tokë në çastet kur vdiq nga droga. Vetëm njëri nga shokët u afrua të sheh nëse është ende i gjallë. Gjëja e parë për të cilën Brajani mendon kur zgjohet në mëngjes është vëllai i tij. Brajani thotë: “Kur mendoj për vëllain tim më kujtohet sesi vjen në shtëpi, mendoj se do të kthehet mirëpo kur më kaplon mërzia mundohem të qetësohem duke e vozitur biçikletën”. Brajani ëndërron të jetojë në vend paqësor me më pak dhunë.

Brajani e ka të vështirë t’iu besojë njerëzve tjerë. Ai thotë se kurrë nuk do t’iu bashkëngjitet bandave, pasi e ka vërejtur se sa ajo që i ka ndodhur vëllait të tij e ka preku atë dhe nënën e tij. Prandaj ai dëshiron të jetë më ndryshe. Ai thotë se bashkëngjitja me ndonjë bandë nuk do ta shpinte atë askund, por thjesht do të përfundonte sikurse vëllai i tij. Përkundrazi ai është i përkushtuar në matematikë dhe aspiron të bëhet mjek ose kontabilist, që të bëjë diçka më të mirë për jetën e tij. Sot Brajani shkon në shkollë në Stanta Tecia, ku UNICEF-i e realizon një program të quajtur “No te digna” (“Ngritu kundër”), që i mëson fëmijët sesi t’i zgjidhin mospajtimet pa dhunë, pasi dhuna është e dëmshme dhe se ata nuk duhet të vuajnë në heshtje. Ne iu kemi ndihmuar fëmijëve, të cilët jetojnë në rrezik sikurse edhe Brajani.

## Shtojca 2: Tregime të fëmijëve të cilët kanë përjetuar situata të dhunës

### **Tregimi i Denisit, Gualtemala**

Denisi është 10 vjeçar dhe shkon në klasë të pestë. Ai jeton me prindërit e tij në Gualtemala në Amerikën Qendrore. Telashet nuk kanë qenë gjithnjë të lidhura vetëm me Denisin. Motra e tij më e vogël ka qenë e kidnapuar si foshnje dymuajshe. Denisi dhe prindërit e tij ende nuk e dinë se ku është ajo.

Denisi dhe familja e tij janë mbështetur nga UNICEF-i përmes *Fondacion Sobrevivientes* (Fondacioni për të mbijetuarit), që iu ndihmon ta gjejnë motrën e tij. Denisi është i brengosur për motrën e tij, ndonëse shpreson se do ta gjejë atë. Ai thotë: “Unë ndjem shumë i mërzhitur për shkak se nuk e kam motrën, por jam i bindur se do te gjej më”.

Gualtemala është njëri ndër shtetet më të rrezikshme në botë për sa i përket sigurisë së fëmijëve. Është shteti i dytë në bota për nga vrasja e fëmijëve. Çdo ditë 40 fëmijë i humbin prindërit e tyre si rezultat i dhunës. Po ashtu për çdo ditë raportohen nga 22 raste të dhunës seksuale ndaj fëmijëve (së paku një në çdo dy orë). Megjithatë shumë pak rastet dalin në gjyq.

## Shtojca 2: Tregime të fëmijëve të cilët kanë përjetuar situata të dhunës

### **Tregimi i Alias nga Nigeria**

Kur Alia ishte 10 vjeçare, familja e saj u informua se anëtarë të Boko Haramit i kanë sulmuar fshatrat në afërsi të tyre në Miçika, Nigeria verilindore. Të nesërmen ata erdhën në fshatin e saj dhe e vranë ia babanë. Alia së bashku me nënën e saj dhe anëtarët tjerë të familjes ia dolën të arratisen në qytezën Mubi, duke braktisur gjithçka prapa vetes.

Pas tre muajsh u sulmua edhe Mubi. Familjarët u detyruan të ikin në shtetin fqinj të Kamerunit. Përfundimisht ata u kthyen përsëri në Nigeri dhe u strehuan në një kamp për persona të zhvendosur si rezultat i dhunës. Tani në kamp Alia po i ndjek mësimet në një shkollë të mbështetur nga UNICEF-i.

Para sulmeve nëna e saj vuante nga shtypja e lartë e gjakut dhe diabeti, andaj tani është shumë e sëmurë, gjë që e bën Alian brengoset edhe më shumë. Alias i mungon babai dhe shoqet. Ajo frikohet se sulmet do të ndodhin përsëri. Megjithatë ajo refuzon të heq dorë. Ajo thotë: “Unë dua të bëhem infermiere, dua t’iu ndihmoj njerëzve”.



## Shtojca 2: Tregime të fëmijëve të cilët kanë përjetuar situata të dhunës

### Tregimi i Suzanës nga El Salvadori

Suzana është 13 vjeçare dhe jeton në El Salvador, në shtetin në të cilin shumë fëmijë janë të futur në banda të fuqishme kriminale. Suzana është pjesë e këshillit për parandalim të dhunës në shkollën e saj, mirëpo shumë shokë dhe shoqe të saj janë përfshirë në dhunën e bandave. Ajo njih fëmijë, të cilët kanë qenë nxënës të mirë, por meqenëse prindërit e tyre kanë pasur probleme, ata e kanë braktisur shkollën, kanë filluar të marrin drogë, madje disa prej tyre edhe kanë vdekur.

Disa nga shoqet e Suzanës kanë lidhje dashurie me djem anëtarë të bandave, gjë që ka shkaktuar që ato të bëhen të dhunshme ndaj Suzanës ose janë vënë në siklet që të bëhen pjesë të aktiviteteve të bandave të detyruara nga anëtarët tjerë të bandave. Suzana është orvatur ta mbështes njërin nga shoqet e saj duke i thënë: “ti mund të zgjedhësh vetë të mos kesh lidhje me djem anëtarë të bandave.” Kushëriri i Suzanës është detyruar të shpërngulet, pasi ka refuzuar t’i bashkëngjitet bandës, pasi ka qenë i brengosur për jetën e tij.

Suzana konsideron se gangsterët janë të dhunshëm për shkak se jetojnë në depresion, pasi ose nuk kanë familje ose janë të braktisur nga familjet. Bandat i bëjnë ata të ndjehen të pranuar ose pjesë e ndonjë strukture. Ajo thotë se liderët e bandave shtiren si bosë. Ata i detyrojnë fëmijët të bëjnë gjëra të tilla, nëse dëshirojnë ta kenë mbështetjen e tyre. Ajo thotë: “ndonjë djalosh mund të pyes se pse duhet të vras, ndërsa lideri i bandës do t’i thotë, për shkak se unë të përkrah ty”.

Grupi i Suzanës për parandalim të dhunës i mëson fëmijët sesi të bëhen prindër të mirë në të ardhmen. Mes tjerash ajo thotë: “Unë do t’i dua fëmijët e mi”. Suzani nuk mendon se është më e guximshme se të tjerët. Ajo ëndërron të jetojë në një shtet të lirë, ku fëmijët, përfshirë edhe ata me jetë të vështirë familjare të kenë më shumë zgjedhje sesa të bëhen pjesë e dhunës së bandave.

## Shtojca 2: Tregime të fëmijëve të cilët kanë përjetuar situata të dhunës

### **Tregimi i Faridës nga Nigeri**

Farida 16 vjeçare u arratis nga shtëpia pasi ishte e abuzuar nga njerka e saj. Mirëpo pasi u largua nga shtëpia ra në duart e bandave të dhunshme në Zinder të Nigerit. Bandat i detyrojnë fëmijët të vjedhin dhe të bëjnë sulme. Vajzat janë në veçanti vulnerebale, madje shpeshherë janë viktime të abuzimit.

Fëmijët kanë të drejtë të rriten të sigurt. Kur fëmijët anekënd botës pyeten se çka i bën të ndjehen të sigurt dhe të lumtur, përgjigja më e zakonshme është dëshira që të jenë me familjen. Megjithatë për shumë prej tyre dhuna fillon shumë herët që në shtëpi.

Në shumë shtete dhuna dhe abuzimi me drogë shumë shpesh është rezultat i veprimit të bandave. Në veçanti kjo ngjan në qytete me rritje të shpejtë, në të cilat nuk është investuar në infrastrukturë ose në sistemin e drejtësisë.

Sot falë qendrës së UNICEF-it për strehim të femrave Farida shkon përsëri në shkollë. Qendra për strehim i ndihmon Faridës dhe viktimave tjera të reja të dhunës të reintegrohen dhe ribashkohen me familjen. Farida thotë: “Unë me të vërtetë dua të bëhem avokate dhe ta mbrojë kauzën e fëmijëve”.

Sot Farida është e sigurt. Mirëpo miliona fëmijë tjerë janë ende të rrezikuara. Ne duhet të bëjmë më shumë që njëherë e përgjithmonë të ndalet dhuna kundër fëmijëve.

## Shtojca 2: Tregime të fëmijëve të cilët kanë përjetuar situata të dhunës

Emri është fiktiv, ndërsa në foto është paraqitur një model

### **Tregimi i Hanit nga SHBA-të**

Hani një djalosh gjashtëmbëdhjetë vjeçar është i lindur në Vietnam, në Azinë juglindore. Kur Hani dhe motra e tij kanë qenë fëmijë të vegjël, kanë qenë të kidnapuar dhe në mënyrë ilegale janë adoptuar nga një grua, e cila jeton në Misuri të SHBA-ve.

Gruaja, e cila ilegalisht e kishte adoptuar Hanin dhe motrën e tij, i kishte detyruar të punojnë dhe të fitojnë para për të. Hani rrëfen: “Ajo më detyronte të shpërndaja gazeta, t’i laj enët në restorant, e nga njëherë edhe të merrem me punët e ndërtimtarisë. Ajo e detyronte motrën time të punojë si pastruese në një hotel në afërsi dhe të gatujë dhe pastrojë shtëpinë”. Ai tregon se nëse nuk ia jepnin gruas të gjitha paratë që i fitonin, atëherë ajo iu jepte dajak.

Pas disa vitesh abuzim Hani i tregoi gjithë rastin Pastorit (priftit) në kishë, te i cili kishte besim. Pastori e kontaktoi Qendrën nacionale kundër trafikimit të qenieve njerëzore, e cila iu ndihmoi Hanit dhe motrës së tij të shpëtojnë nga vështirësitë dhe të marrin ndihmë mjekësore dhe këshillim. Po ashtu ua gjeti një vend të sigurt për jetesë. Hani thotë: “Tani mund të fillojmë të shërohemi nga ato vite të eksploatimit”.

Sot Hani dhe motra e tij janë të sigurt, mirëpo ende shumë fëmijë tjerë janë në rrezik. Prandaj duhet të veprojmë më shumë, që ta ndërpresim dhunën, eksploatimin dhe abuzimin e fëmijëve.

*Studime rasti të Polaris (organizatë e prindërve në kuadër të Qendrës nacionale kundër trafikimit të qenieve njerëzore) dhe TeachUnicef-it.*

Njohja e Dhunës në Bashkësi

Shtojca 2: Tregime të fëmijëve të cilët kanë përjetuar situata të dhunës

**Tregimi i**